

Doracaku **VEGA:** Fëmijët në aeroporte

FËMIJËT NË RREZIK GJATË LËVIZJES
UDHËZUES PËR ROJET KUFITARE

MARRI

Migration, Asylum, Refugees Regional Initiative



Doracaku

VEGA:

Fëmijët në aeroporte

**FËMIJËT NË RREZIK GJATË LËVIZJES
UDHËZUES PËR ROJET KUFITARE**





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation



Plac Europejski 6
00-844 Varshavë, Poloni

Telefoni: +48 22 205 95 00
Faksi: +48 22 205 95 01

frontex@frontex.europa.eu
www.frontex.europa.eu

©Frontex, 2015
Varshavë, gusht 2015

Versioni i shtypur:

TT-02-17-558-SQ-C
ISBN 978-92-9471-228-8
doi:10.2819/030229

PDF:

TT-02-17-558-SQ-N
ISBN 978-92-9471-229-5
doi:10.2819/941042

Përmbajtja

Si ta përdorni këtë Doracak #5

Parathënie #7

1. Përkufizimet #11

- 1.1. Fëmija #13
- 1.2. Rreziku i fëmijëve në lëvizje #13
- 1.3. Fëmijët e shoqëruar #15
- 1.4. Fëmijët e pashoqëruar #16
- 1.5. Fëmijët e ndarë #16
- 1.6. Trafikimi i fëmijëve #18
- 1.7. Kontrabanda e fëmijëve #19
- 1.8. Interesi më i mirë i fëmijës #21
- 1.9. Mbrojtja dhe mekanizmi kombëtar i referimit #22

2. Udhëzime operative #23

- 2.1. Hyrje #25
- 2.2. Trajtimi i fëmijëve #26
- 2.3. Qëndrimi me fëmijën në ambientet kufitare #29

3. Fëmijët e shoqëruar dhe të ndarë #31

- 3.1. Kur iu afrohet pikave të kontrollit dhe në vijën e parë të kontrollit #33
- 3.2. Vija e dytë e kontrollit #38
- 3.3. Zona e transitit dhe porta e kontrollit #43
- 3.4. Vendimi përfundimtar dhe udhëzimi #44

4. Fëmijët e pashoqëruar #47

- 4.1. Kur i afrohet kontrollit dhe në vijën e parë të kontrollit #49
- 4.2. Vija e dytë e kontrollit #51
- 4.3. Vendimi përfundimtar dhe udhëzimi #53

5. Informacione plotësuese #55

- 5.1. Grumbullimi i të dhënave #57
- 5.2. Mbrojtja e të dhënave #57
- 5.3. Përfaqësuesit konsullorë të shteteve të treta #58
- 5.4. Procedurat e transportuesve ajrorë për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar #58

6. Mbrojtja dhe mekanizmat kombëtare për referim #61

7. Fjalori #67

Si ta përdorni këtë Doracak

Rekomandimet e dhëna në këtë doracak synojnë ta rrisin ndërgjegjësimin e zyrtarëve, gjegjësisht rojeve kufitare në lidhje me fëmijët (të miturit), të cilët kalojnë kufirin ajror të jashtëm të Bashkimit Evropian, pavarësisht nëse janë vetëm ose të shoqëruar nga ndonjë person tjetër. Në këtë mënyrë mund të përmirësohet identifikimi i fëmijëve, të cilët gjenden në rrezik gjatë lëvizjes së tyre në aeroport, duke siguruar respektimin e të drejtave të tyre dhe rritjen e veprimeve të ndërmarra kundër kërcënimeve kriminale ndaj mirëqenies së fëmijëve.

Doracaku përmban veprime të përshtatshme operationale për kontroll në hyrje, transit dhe dalje, të projektuar pavarësisht nga prania e mundshme por e rrallë e oficerëve të specializuar për të drejtat e fëmijëve ose për mbrojtjen e tyre. Udhëzimet e dhëna njashtu përpiqen të reflektojnë dhe sigurojnë që në çdo kohë të zbatohet një qasje e bazuar në të drejtat e fëmijës, njëkohësisht duke marrë parasysh nevojat dhe detyrimet konkrete të aktiviteteve të rojeve kufitare.

Ky doracak është projektuar për rojet kufitare me përvojë dhe bazohet në parimet e interesave më të mira të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijëve në kufi.

Udhëzimet duhet të implementohen:

- në përputhje me rregullat dhe kompetencat kombëtare të organizimit të punës së autoriteteve të rojeve kufitare;
- duke pasur parasysh se veprimet e sugjeruara nga Frontex-i përfshijnë të gjitha aktivitetet e kontrollit kufitar deri në momentin, kur në bazë të rrethanave mund të kemi dyshim të arsyeshëm që një fëmijë mund të jetë në rrezik. Pas kësaj, mekanizmi i referimit dhe investigimi fillestar do të zbatohen

sipas legjislacionit përkatës kombëtar për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e personave vulnerabil, në veçanti duke u bazuar në interesat më të mira të fëmijës, që duhet të jetë një pikësynim parësor së bashku me parimin e moskthimit¹

Të gjithë rojet kufitare të përfshira janë të ftuar të kontrollojnë në terren të dhënat e përmendura në këto udhëzime, dhe njëkohësisht t'i dërgojnë rekomandimet ose komentet e tyre në adresën e mëposhtme të Frontex-it:
VEGA.Children@frontex.europa.eu.
Tema: "Doracaku VEGA për fëmijë, komente".

¹ Kthimi (refuzimi) nënkupton dëbimin e personave, që kanë të drejtë të jenë të pranuar si refugjatë. Parimi i mos-kthimit është përcaktuar për herë të parë në vitin 1951 në Konventën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e refugjatëve (CRSR), neni 33 (1) i cili thekson se "Në asnjë mënyrë asnjë shtet nënshkrues nuk do të dëbojë dhe nuk do të kthejë ndonjë refugjat ["refouler" në frëngjisht] në kufijtë e territoreve, ku do të kërcënohej jeta ose liria e tij mbi bazë të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë brenda një grupi të veçantë shoqëror, ose opinionit politik"

Parathënie

Fëmijët, për dallim nga të rriturit, për shkak të moshës dhe nivelit të pjekurisë së tyre janë në përgjithësi më shumë të rrezikuar nga abuzimi. Gjatë 20 viteve të fundit rrjetet kriminale ndërkombëtare të lidhura me migracionin e parregullt janë bërë gjithnjë e më të sofistikuar. Natyra e kontrabandës dhe trafikimi i fëmijëve e vështirëson gjetjen e shifrave të sakta, mirëpo shumica e analistëve pajtohen se ka pasur një rritje në këto kategori të krimit ndërkufitar (Raporti Global i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) për vitin 2012 tregon se rreth 27% e viktimave të zbuluara të trafikimit në periudhën 2007-2010 ishin fëmijë, në krahasim me 20% në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2006). Të dhënat më të fundit statistikore të Eurostat-it, të publikuara në tetor të vitit 2014, tregojnë se 17% e numrit të përgjithshëm të viktimave të trafikimit në Bashkimin Evropian janë nga moshën 12 deri në moshën 17 vjeçare.

Përveç kësaj, çdo vend ka interpretimin dhe kategorizimin e vetë të fenomenit të fëmijëve të prekur nga krimi ndërkufitar.

Në këtë kontekst, roli primar i rojeve kufitare është identifikimi i fëmijëve në rrezik të veçantë; rojet kufitare gjithashtu luajnë rol vendimtar për të mundësuar që ata fëmijë, pavarësisht nga moshën e tyre, të udhëzohen tek autoritetet përgjegjëse dhe shërbimet përkatëse, me qëllim që t'u sigurohet mbrojtje dhe mirëqenie e mëtejme. Paralelisht me këtë ata kanë për detyrë t'i zbulojnë dhe ndërpresin aktivitetet e ndërmjetësuesve, kontrabandistëve dhe/ose trafikantëve. Informacionet e grumbulluara mbi inteligjencën gjatë këtij procesi janë shpeshherë me rëndësi kritike për përpjekjet e policisë për të detektuar dhe nënshtruar rrjetet ndërkombëtare kriminale.

Nuk është e lehtë lufta me kriminelët dhe modus operandin e tyre që gjithnjë ndryshon; për të ditur sesi të zbuloni një fëmijë që është në rrezik konkret, duhet të posedoni aftësi të specializuara, të cilat shpeshherë mund të mungojnë në pikat kryesore hyrëse të Bashkimit Evropian. Për më tepër, trajtimi i fëmijëve vulnerabil - duke përfshirë edhe mënyrën si të flisni me ta, si t'iu drejtoheni atyre dhe se si të veproni me ta pa ua cenuar integritetin, të drejtat ose interesat e tyre - është një çështje shqetësuese në shumicën e vendeve të botës, gjë që paraqet sfidë të mëtejshme për çdo shërbim të rojeve kufitare.

Qëllimi i këtij doracaku të Frontex-it është që t'i adresojë këto mangësi dhe t'i mbështetë proceset kyçe në lidhje me identifikimin e rrezikut të fëmijëve në lëvizje, në lidhje me aktivizimin e udhëzimeve tek autoritetet përkatëse. Në të kaluarën janë bërë shumë studime mbi mirëqenien, mbrojtjen dhe udhëzimin e fëmijëve të identifikuar si në rrezik, por asnjëri nga ata nuk ka ofruar elemente të veçantë të udhëzimeve praktike për zbatimin e ligjit. Madje asnjëri prej tyre nuk ka ofruar perspektiva për aktivitetet në kufi të rojeve kufitare, të cilët shpesh luajnë një rol kyç në iniciimin e këtyre proceseve dhe shpërbërjen e organizatave kriminale.

Qëllimi kryesor i këtij doracaku është rritja e efektivitetit të "Mbrojtjes së fëmijëve në lëvizje" në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe operacionale.

Duke u mbështetur në njohuritë e ekspertëve kryesorë të Evropës, si dhe në përvojën e grumbulluar nga dhjetëra roje kufitare, ky doracak mbulon çdo aspekt të kontrollit të hyrjes, transitit dhe daljes në rastet e migracionit të parregullt dhe kriminit ndërkufitar, që përfshin fëmijët në aeroporte.

Përmbytja e këtij doracaku është projektuar që të jetë në veçanti e lehtë për zbatim nga rojet kufitare, por edhe është fuqishëm

e orientuar drejt zbatimit të ligjit, ndonëse në të njëjtën kohë i mbulon aspektet përkatëse të integritetit të fëmijëve dhe nevojat e tyre për mbrojtje.

Megjithëse kryesisht ka për qëllim shërbimet e rojës kufitare, doracaku duhet gjithashtu të jetë me interes për njerëzit e tjerë, duke filluar nga stafi i aeroportit dhe ai i linjës ajrore, përgjegjësit për fëmijët e pashoqëruar gjatë fluturimeve e deri te stafi i qendrave për pranim si dhe ai i shërbimeve dhe agjencive tjera, qofshin ato shtetërore ose private, të cilat mund të gjejnë disa sugjerime, sesi të merren me çështjen e vështirë të fëmijëve në rrezik.

1. Përkufizimet



Për nevojat e këtij doracaku janë përdorë këto përkufizime.

1.1. Fëmija

Sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar dhe evropian, fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare, përveç nëse sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijë, mosha madhore arrihet më herët.

Konvencionalisht, termat “nën moshën madhore” ose “minoren” mund të përdoren gjithashtu edhe për të përshkruar çdo person nën moshën 18 vjeçare. Madje shumica e kompanive ajrore e klasifikojnë fëmijën nën moshën 3 vjeçare si “foshnje”. Në fakt, me rëndësi është të kuptohet se kush është subjekti i këtij studimi, e jo vetë emërtimi.

Kur mosha e një personi është e pasigurt dhe ka arsye për të besuar se ai/ajo mund të jetë fëmijë, atëherë ai/ajo duhet të trajtohet si i/e tillë, nëse është e nevojshme, t'i ofrohet ndihmë e menjëhershme, mbështetje dhe mbrojtje derisa të bëhet një vlerësim i duhur i moshës (d.m.th. një supozim i moshës më të vogël). Prandaj, nëse ka ndonjë dyshim, gjithnjë duhet të ekzistojë supozimi për moshën e fëmijërisë, por edhe trajtimi miqësor i përshtatshëm për moshën që ka fëmija.

1.2. Rreziku i fëmijëve në lëvizje

Fëmijët, sipas natyrës së tyre, janë më të ndjeshëm sesa të rriturit. Varësisht nga mosha dhe niveli i pjekurisë, deri në njëfarë shkalle fëmijët i përmushin nevojat e tyre bazë, duke u mbështetur në personat e rritur. Disa fëmijë që udhëtojnë nëpër kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian janë më të ndjeshme se të tjerët. Kur nuk kanë kujdesin dhe mbrojtjen adekuate ose të

drejtat e tyre si fëmijë janë të rrezikuara, ata përkufizohen si “fëmijë në rrezik”. Këta fëmijë duhet të bëhen prioritet për rojet kufitare, ndonëse bërja e gjykimeve të tilla nuk është kurrë e lehtë, madje edhe për punonjësit më me përvojë në këtë fushë.

Grupi ndërinstitucional i punës për fëmijët në lëvizje² ka ranë dakord për një përkufizim se kur fëmijët duhet të konsiderohen “në lëvizje”. Grupi doli me një koncept të gjerë, duke përfshirë fëmijët me prejdardhje të ndryshme dhe me eksperiencë të ndryshme. Përkufizimi thotë siç vijon: *“fëmijët që lëvizin për një sërë arsyesh, vullnetarisht ose pa dashje, brenda shtetit ose ndërmjet shteteve, me ose pa prindërit e tyre ose me kujdestarët primarë, lëvizja e të cilëve mund të hapë mundësi, por edhe mund t’i vërë ata në rrezik (ose në një rrezik në rritje) për shfrytëzim ekonomik ose seksual, abuzim, neglizhim dhe dhunë. Fëmijët përjetojnë rreziqe të veçanta si pasojë e migrimit”*.

Fëmijët në rrezik zakonisht përkufizohen si persona, që nuk kanë mbrojtje dhe kujdes dhe nuk i kanë të plotësuar nevojat themelore të tyre (ushqimi, uji, veshja, strehimi, barëra etj.) dhe nuk gëzojnë mirëqenie. Si rezultat i kësaj, ata mund që kurrë të mos e arrijnë potencialin e tyre të plotë, fizik, social, emocional ose mendor. Në këso situata, ata janë veçanërisht vulnerabil dhe në rrezik për t’u shfrytëzuar, qoftë nga kontrabanda kriminale dhe rrjetet e trafikimit ose edhe nga vetë prindërit dhe familjet e tyre.

² Në vitin 2011 është themeluar Grupi ndërinstitucional i punës për fëmijët në lëvizje, i cili përfshin këto organizata: Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Plani Ndërkombëtar, Save the Children (Shpëtoni Fëmijët), Federata Ndërkombëtare Terre des Hommes, Lëvizja Afrikane e Fëmijëve dhe të Rinjve në Punë (AMWCY / MAEJT), Veprimi për zhvillim mjedisor në Botën e Tretë (ENDA), Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) dhe Vizioni Ndërkombëtar Botëror.

Fëmijët në rrezik përfshijnë fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët jetimë, fëmijët e rrugës, fëmijët punëtorë, fëmijët e prekur nga konfliktet e armatosura dhe fëmijët ushtarë, fëmijët e prekur nga HIV/SIDA, fëmijët e shfrytëzuar seksualisht, fëmijët e abuzuar dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Mënyrat sesi një fëmijë mund të marginalizohet, stigmatizohet ose diskriminohet janë pothuajse të pafundme dhe gjithashtu mund të dallojnë në shoqëri të ndryshme.

Llojet e kërcënimeve që prekin fëmijët janë jashtëzakonisht të ndryshme (kontrabanda, trafikimi, qoftë për qëllimin e punës së detyruar, detyrim për t'u bërë lypsar, ose duke u detyruar në aktivitete të tjera kriminale etj.), prandaj edhe është vështirë që të kategorizohen.

Shumë fëmijë bëjnë pjesë në më shumë se një kategori të vulnerabilitetit ose kërcënimit, që rrit shkallën e ndjeshmërisë dhe vështirësisë në identifikimin e nivelit të rrezikut (si një funksion i cënueshmërisë dhe kërcënimit). Për shembull, fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë (shih Pjesën 2.4 dhe 2.5) konsiderohen si jashtëzakonisht vulnerabil ndaj rrezikut të trafikimit, abuzimit ose dhunës dhe/ose shfrytëzimit.

Zakonisht fëmijët nuk janë në gjendje të artikulojnë qartë ose të shpjegojnë (siç edhe potencon UNHCR-ja).

1.3. Fëmijët e shoqëruar

Këta janë persona nën moshën 18 vjeçare, të cilët të paktën janë të shoqëruar nga njëri prind i tyre ose nga kujdestari i parë ligjor/zakonor.

1.4. Fëmijët e pashoqëruar

Fëmijët e pashoqëruar, të njohur edhe si persona të mitur të pashoqëruar ose (PMP), janë fëmijët e ndarë nga të dy prindërit dhe të afërmit e tjerë, ose të rriturit përgjegjës, gjegjësisht ata që nuk gjenden nën kujdesin e një të rrituri, që ka përgjegjësi ligjore ose zakonore.

Fëmijët që braktisen pasi hyjnë në territorin e një vendi – që për shembull mund të ndodhë, brenda një kohe të shkurtër pas zbritjes së avionit dhe mbërritjes në sportelin për imigracion në aeroport- gjithashtu përcaktohen si fëmijë të pashoqëruar.

Këta fëmijë duhet të mbrohen plotësisht, për aq kohë sa nuk merren nën kujdesin e një të rrituri ligjor ose zakonor.

1.5. Fëmijët e ndarë

Fëmijët e ndarë konsiderohen fëmijët e ndarë nga njëri ose të dy prindërit, ose nga kujdestari i tyre i mëparshëm ligjor ose zakonor, por jo domosdoshmërisht edhe nga të afërmit e tjerë. Pra këtu mund të përfshihen fëmijët e shoqëruar nga anëtarë tjerë të rritur të familjes (p.sh. xhaxhai ose gjyshi).

Të gjithë fëmijët, e në veçanti ata që janë më vulnerabil, siç janë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, kanë të drejtë të kenë të garantuar mbrojtjen e tyre. Masat e reagimit përfshijnë: identifikimin adekuat pasi të arrijnë në portet e hyrjes ose sa më shpejt pasi që autoritetet të njoftohen për praninë e tyre në vend; regjistrimin e menjëhershëm dhe përcaktimin e ekzistimit të mundshëm të mbrojtjes ndërkombëtare (duke përfshirë moskthimin) dhe në rast nevojë, gjurmimi i anëtarëve të familjes, aty ku është

e mundur, emërimin e kujdestarit dhe përfaqësuesit ligjor; kujdesin dhe rregullimin e akomodimit; qasjen e plotë në arsim, shërbimet shëndetësore dhe standardet adekuate jetësore; qasjen e lehtësuar në procedurat e azilit, aty ku është e aplikueshme; dhe qasjen e garantuar në format plotësuese të mbrojtjes³.

Çdo vendim lidhur me këta fëmijë vulnerabil duhet të marrë në konsideratë situatën e tyre të veçantë, si dhe kornizën ligjore kombëtare dhe rajonale, ligjin për refugjatët si dhe ligjin për të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Parimet e mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijës gjithashtu duhet të jenë në konsideratë primare, kur bëhet fjalë për trajtimin e këtyre fëmijëve nga zyrtarët e emigracionit, policët dhe çdo punonjës tjetër i rëndësishëm, i cili merret me ta.

Pavarësisht nga kategorizimet e mëposhtme, të gjithë fëmijët kanë të drejtë të dorëzojnë një kërkesë për azil, ku të përcaktohet, vlerësohet dhe garantohet interesi i tyre më i mirë. Nëse ka ndonjë dyshim lidhur me **moshën reale të fëmijës në fjalë, atëherë duhet të sigurohet referimi në mekanizmat e procedurës për vlerësim të akredituar të moshës.**

Sipas legjislationit të Bashkimit Evropian, shqetësimet dhe statusi i migrimit nuk mund të jenë bazë për refuzimin e ndonjë mase mbrojtëse, duke përfshirë edhe lejen për të hyrë ose për të qëndruar në një vend anëtar të Bashkimit Evropian.

³ Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i përgjithshëm nr. 6 (2005) mbi trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të originës.

1.6. Trafikimi i fëmijëve

Trafikimi i qenieve njerëzore (THB) përcaktohet nga direktiva e BE-së për trafikimin si rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, në këtë rast pranimi i fëmijëve, duke përfshirë edhe shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta fëmijë me qëllim të shfrytëzimit të tyre⁴.

Kjo mund të ndodhë me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës ose të formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të fuqisë ose pozicionit të vulnerabilitetit, ose dhënies dhe pranimit të pagave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër.

Megjithatë, neni 2 (5) i Direktivës mbi trafikimin është shumë i qartë: nëse qëllimi përfundimtar është shfrytëzimi i fëmijës, trafikimi i qenieve njerëzore është krim i dënueshëm, edhe kur nuk është përdorur asnjëra nga mjetet e lartpërmendura.

Trafikimi i fëmijëve nuk është vetëm një krim ndërkuftar: meqenëse qëllimi i aktivitetit kriminal është shfrytëzimi i fëmijëve, fëmijët mund të trafikohen edhe brenda kufijve kombëtarë.

Përveçse trafikimit, disa fëmijë mund të kenë nevojë edhe për lloje të tjera të mbrojtjes ndërkombëtare, siç është azili. Fëmijët sikurse të rriturit e gëzojnë të drejtën e njëjtë të moskthimit.

⁴ Direktiva e BE-së 2011/36 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës nga 5 prilli i vitit 2011 lidhur me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen e viktimave dhe zëvendësimi i Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/629/ JHA (Neni 2 (1)). Neni 2 (3) përcakton qëllimet e shfrytëzimit që përfshijnë "si minimum shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion ose forma tjera të shfrytëzimit seksual, detyrimin për punë ose shërbime, duke përfshirë detyrimin për t'u bërë lypës, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose shfrytëzimin e veprimtarive kriminale, përfshirë edhe heqjen e organeve".

Këto të drejta janë të përcaktuara qartë në acquis e Bashkimit Evropian për azil⁵.

1.7. Kontrabanda e fëmijëve

Kontrabanda e fëmijëve paraqet mundësi, për sigurim të drejt-përdrejtë ose të tërthortë të përfitimit financiar ose përfitimi tjetër material, nga hyrjet e parregullta të një fëmije në një shtet, në të cilin fëmija nuk është as shtetas e as rezident i përhershëm⁶.

Edhe pse ky lloj krimi ka ngjashmëri me trafikimin e fëmijëve, prapëseprapë këto dy nocione nuk duhet të ngatërrohen.

- ♦ Qëllimi i trafikimit është shfrytëzimi i një qenieje njerëzore dhe konsiderohet si krim kundër personit. Qëllimi i kontrabandës është mundësia që një person ta kalojë kufirin në mënyrë të parregullt, gjë që konsiderohet si krim kundër sovranitetit të një shteti.
- ♦ Trafikimi përfshin qëllimin për të shfrytëzuar njerëzit pas ardhjes së tyre në një shtet, ndërsa roli i një kontrabandist zakonisht përfundon sapo klienti të arrijë destinacionin e tij/saj.
- ♦ Trafikimi mund të bëhet si brenda ashtu dhe në të gjithë kufijtë kombëtarë, ndërkohë që kalimi i kufirit është i nevojshëm në rastin e kontrabandës. Hyrja e fëmijëve në një shtet mund të jetë e rregullt ose e parregullt në rastin e trafikimit, ndër-

⁵ Direktiva 2011/95 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 13 dhjetor 2011 mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që gëzojnë të drejtën për mbrojtje plotësuese dhe për përmbytjen e mbrojtjes së dhënë (rishikim).

⁶ Bazuar në Protokollin kundër Kontrabandës së Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Protokollet e Palermos 2000).

kohë që kontrabanda përgjithësisht karakterizohet me hyrje të parregullt.

- Në rastin e të rriturve, trafikimi kryhet përgjithësisht përmes detyrimit dhe/ose mashtrimit. Mirëpo në rastin e kontrabandës ndodh e kundërta: personat e kontrabanduar pothuajse gjithmonë janë dakord me kontrabandistët. Sidoqoftë, kur kemi të bëjmë me fëmijë situata është më komplekse; Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC) nje nivelin e përfshirjes së fëmijës, por gjithashtu sqaron se kjo varet nga mosha dhe niveli i pjekurisë së tij/saj. Për më tepër, shikuar nga aspekti ligjor pëlqimi i prindërve kërkohet gjithashtu për aktet që kanë të bëjnë me fëmijët. Çështje të ndryshme, siç është niveli i pjekurisë së fëmijës dhe kuptimi pasues i situatës nga ana e tij/saj, ose gjëra të ngjashme, kanë nevojë për
- vëmendje të mëtejshme në rastet që përfshijnë fëmijët. Siç ka vërejtur Interpoli, metodat e veprimit të trafikantëve dhe kontrabandistëve janë të ngjashme në shumë aspekte, gjë që mund ta vështirësojë shumë punën e zyrtarëve për zbatimin e ligjit për të bërë dallim ndërmjet këtyre dy llojeve të ndryshme të krimit. Në shumë raste, mundet të mos jetë e mundur të bëhet dallimi ndërmjet trafikimit dhe kontrabandës deri në përfundimin e fazës së transportit dhe fillimit të fazës së shfrytëzimit⁷.

E drejta për azil dhe parimi i moskthimit gjithashtu zbatohen për fëmijët e kontrabanduar, të cilët mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

⁷ Raporti i aktivitetit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së njerëzve 2010-2011, botuar në maj të vitit 2012.

1.8. Interesi më i mirë i fëmijës

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës përcakton se *“interesat më të mirë të fëmijës duhet të jetë në rend të parë në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët, qofshin ato të ndërmarra nga institucionet publike të mirëqenies sociale ose ato private, gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative”*. Veprimi në interesin më të mirë të fëmijës duhet të jetë parimi udhëheqës i çdo rojeje kufitare. Nevoja për të pasur konsideratë primare për interesin më të mirë të fëmijës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të është gjithashtu e rregulluar me nenin 24 të Kartës së Bashkimit Evropian mbi të Drejtat Themelore.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës⁸ ka theksuar së fundmi se *“koncepti i interesave më të mira të fëmijës është kompleks, ndërsa përmbajtja e tij duhet të përcaktohet veç e veç nga rasti në rast”*. Interesat më të mira të fëmijës duhet të përcaktohen nga autoritetet kompetente për mbrojtjen e fëmijës brenda një vendi, në mënyrë që të zbatohen procedurat e nevojshme për një zgjidhje të shpejtë të rasteve praktike. Rojet e kufirit luajnë një rol kyç në këtë proces. Ata duhet t'i referojnë të gjitha rastet, për të cilat ka indikacion se ekziston rreziku për ndonjë fëmijë, duke u bazuar në përshkrimin e bërë në këtë doracak.

Kjo kërkon kapacitete që rojet kufitare zakonisht nuk i kanë, sidomos kur në kufijtë e jashtëm brenda pak sekondash duhet zbuluar fëmija në rrezik; prandaj, kompleksiteti i detyrës me të cilën përballen rojet kufitare edhe mjaft i rëndësishëm.

Është thelbësore që rojet e kufirit të marrin një qasje veçanërisht fleksibël kur ballafaqohen me raste që përfaqësojnë fëmijë. Interesat e një fëmije në një pozitë specifike të cënueshmërisë nuk janë gjithmonë më së miri të përmbushura dhe në të njëjtën mënyrë

⁸ UNCRC, Komenti i përgjithshëm nr. 14 (2013).

si ato të një fëmije tjetër në situata të ngjashme. Një roje kufitare me përvojë e di se nuk ka të ngjarë që edhe dy raste të jenë të njëjta, andaj vazhdojnë me kujdes dhe vlerësim gjithëpërfshirës kur kanë të bëjnë me fëmijët. Është e nevojshme të mblidhen sa më shumë informacione mbi rastet me fëmijë para se të merret ndonjë vendim.

1.9. Mbrojtja dhe mekanizmi kombëtar i referimit

Mekanizmi kombëtar i referimit (MKR/NRM) është një sistem dhe mekanizëm, i cili i lejon një vendi të adresojë detyrimin e vetë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit dhe personat e tjerë vulnerabil, nëpërmjet një reagimi të koordinuar, shpesh me asistencë të specializuar të institucioneve të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare (OJQ). Ekzistojnë dallime procedurale midis MKR-së së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ndonëse të gjithë kanë një qëllim të përbashkët: referimin efikas të personave vulnerabil për mbështetje më të mirë dhe shërbim sa më adekuat. Shih Kapitullin 7 për diskutime më të detajuara të MKR-së, që është me rëndësi për të gjithë fëmijët në rrezik, e jo vetëm për ata që janë në rrezik nga trafikimi.

2. Udhëzime operative



2.1. Hyrje

Kontrollet kufitare janë një mundësi e rëndësishme që rojet e kufijve ta parandalojnë krimin ndërkufitar: sepse pasi viktimat të largohen nga aeroportet zvogëlohen shumë mundësitë për të kapur kriminelët dhe për të parandaluar veprimet e tyre, po ashtu zvogëlohet edhe mundësia e zbulimit të viktimave dhe e aktivizimit të masave për mbrojtjen e fëmijëve. Edhe sa viktima të tjera të fëmijëve do të vuajnë, nëse këto rrjete kriminale nuk shpërbehen?

Sipas Europolit, aeroportet janë vendi më i përshtatshëm për të zbuluar fëmijët që trafikohen apo kontrabandohen në Bashkimin Evropian. Kontrabandistët dhe trafikantët preferojnë aeroportet, madje modus operandi i tyre i zakonshëm është përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, ose dokumenteve të personave tjerë, me qëllim që t'ia dalin t'i shmangen sistemeve përkatëse.

Gjithandej njihet fakti se është vështirë të zbulohen krimet kufitare, të cilat përfshijnë fëmijët. Janë të zakonshme rastet, kur fëmijës së trafikuar i jepet të udhëtojë me pasaportë origjinale të personave të rritur, me të cilin nuk ka lidhje familjare ose lidhje të kujdestarisë. Edhe kur pasaporta përmban një fotografi të fëmijës, vetë procesi i identifikimit mund të jetë i ndërlikuar nga fakti se fytyrat e pazhvilluara (të fëmijëve) ka të ngjarë të duken të ngjashme, pasi vetë fytyra e fëmijëve, flokët dhe madje edhe ngjyra e syve shpesh ndryshojnë në mënyrë dramatike gjatë rritjes. Si rezultat i kësaj, roja kufitare mund të mos e vërejë se fëmija dhe bartësi i pasaportës (personi i rritur) në realitet nuk kanë lidhje mes tyre.

Kontrabandistët dhe trafikantët zakonisht përpiqen të arrijnë në periudhën kur ka më shumë pasagjerë, kur presioni në kontrollin e pasaportave është më i madh: rojet kufitare duhet të

jenë të vetëdijshëm për këtë modus operandi në mënyrë që t'i mbrojnë fëmijët sa më mirë.

Përvoja e fituar ndër vite nga Frontex-i tregon se prapa një kalmi të parregullt kufitar mund të jetë rasti i kontrabandimit të njerëzve. Kjo do të thotë se çdo rast i trafikimit që zbulohet në kufirin e jashtëm është rezultat i një përshkallëzimi të kontrolleve, gjë që po ashtu vlen edhe kur përfshihen fëmijët.

Për të rritur ndërgjegjësimin për rrezikun e fëmijëve në lëvizje, është thelbësore që të zhvillohet dhe të mirëmbahet një marrëdhënie e mirë me zyrtarët e tjerë të zbatimit të ligjit në aeroport, siç janë stafi i linjës ajrore, punëtorët nga shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve, personat që punojnë me grupet e tjera vulnerabil⁹ dhe autoritetet e tjera. Kjo mund të arrihet nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese, kurseve për trajnim të përbashkët, ekipeve të përbashkëta të specializuara etj.

2.2. Trajtimi i fëmijëve

Është e rëndësishme të kuptohet se fëmijët janë psikologjikisht të ndryshëm nga të rriturit; prandaj kur punohet me fëmijë, nevojitet një qasje e ndjeshme ndaj tyre. Po ashtu, një fëmijë mund të mos jetë i gatshëm të hapet para një të huaji, prandaj zyrtari (mundësisht i veshur në rroba civile) që punon me fëmijën, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të vendosur mirëbesim me fëmijën.

Praktikat e mira që duhen pasur parasysh kur merreni me fëmijët:

⁹ Përfshirja e organizatave ndërkombëtare të akredituara dhe OJQ-ve

- ♦ krijoni një mjedis miqësor (ajo mund të jetë një dhomë e përshtatshme për fëmijën¹⁰, nëse një gjë e tillë është në dispozicion), zvogëloni diferencën e fuqisë (shmanguni formaliteteteve, kini kujdes me gjuhën e trupit, tonin verbal, shprehjet e përdorura, etj.) dhe lejoni fëmijën t'i përshtatet mjedisit;
- ♦ sqaroni rolet dhe vendet e punës së të rriturve që janë të përfshirë në veprimin me fëmijën;
- ♦ gjithnjë tregoni të vërtetën;
- ♦ dëgjoni fëmijën;
- ♦ flisni në gjuhën e thjeshtë dhe shmanguni termave teknike (keni parasysh barrierat gjuhësore);
- ♦ flisni dhe silluni në një mënyrë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e pjekurisë së fëmijës;
- ♦ përpiquni të bëni fëmijën të ndjehet rehat;
- ♦ përshtatni mënyrën e sjelljes (p.sh. mbani kontaktin me sy, uluni në të njëjtin nivel).

Informacioni bazë mbi trajtimin e fëmijëve gjendet në Doracaku praktik për rojet kufitare¹¹, ku mes të tjerash specifikohet:

"Të miturit meritojnë vëmendjen e veçantë të rojeve kufitare, qoftë nëse ata janë të shoqëruar gjatë udhëtimit ose janë vetëm.

Në rastin e të miturve të shoqëruar, roja kufitare duhet të kontrollojë personat që shoqërojnë të miturit, nëse kanë kujdestarinë prindërore mbi ta, sidomos kur të miturit janë të shoqëruar vetëm nga një i rritur dhe ka bazë serioze për të dyshuar se ata mund të kenë qenë në mënyrë

¹⁰ Mbani mend se një dhomë e përshtatshme mund të sigurojë privatësi, por, nga ana tjetër, hyrja në një dhomë të tillë mund të jetë e frikshme për fëmijën. Prandaj, dhomë adekuate është vetëm dhoma e përgatitur ekskluzivisht për ngjarje të tilla.

¹¹ Rekomandimi i Komisionit, për hartimin e një "Doracaku të përbashkët praktik për rojet kufitare" (Doracaku Shengen)", që do të përdoret nga autoritetet kompetente të vendeve anëtare gjatë kryerjes së kontrollit kufitar të personave, C (2006) 5186 final, Bruksel, 6.10.2006.

të paligjshme të larguar nga kujdesi i personit që ligjërisht ushtron rolin e prindit ose kujdestarit të tyre. Nëse has në raste të tilla, roja kufitare do të duhet t'i bëjë të gjitha hetimet e nevojshme për të parandaluar rrëmbimin ose largimin e paligjshëm të të miturit.

Të miturit e pashoqëruar duhet të shqyrtohen, përmes një kontrolli të tërësishëm të udhëtimit të tyre dhe dokumenteve mbështetëse, për të siguruar që fëmijët nuk largohen nga territori kundër vullnetit të personit që ushtron kujdesin prindëror."

Kur ka dyshime për ndonjë nga rrethanat e lartpërmendura të përcaktuara në Doracakun praktik për rojet kufitare, atëherë rojet kufitare duhet ta përdorin listën e qendrave kombëtare të kontaktit për konsultime lidhur me personat e mitur.

Ndonëse Doracaku praktik për rojet kufitare tregon qartë se kujdesi prindëror është kriteri sipas së cilit kategorizohen fëmijët e shoqëruar dhe ata të pashoqëruar, prapëseprapë rojet kufitare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjithë fëmijëve që udhëtojnë, qoftë ata të shoqëruar, të pashoqëruar ose të ndarë.

Përveç informacionit të dhënë në Doracakun praktik për rojet kufitare dhe Kodin e Kufijve të Shengenit, kapitujt e këtij doracaku do t'iu sigurojnë rojeve kufitare procedura të detajuara dhe specifike, të cilat duhet të ndiqen kur merren me fëmijët dhe duhet të identifikojnë viktimat e kontrabandës dhe trafikimit të fëmijëve.

Rekomandimet mund të ndryshojnë varësisht nga legjislatiioni përkatës kombëtar, por secili fëmijë duhet të marrë trajtim të posaçëm, ndërsa rojet e kufirit duhet të jenë të vetëdijshëm për indikatorët e dhënë lidhur me fëmijët në rrezik.

Megjithatë, këto rekomandime nuk janë shteruese: rojet e kufirit duhet të jenë të vetëdijshëm për modus operandi të ndryshëm. Në fakt modus operandi është përcaktuar sipas përgjigjeve të

marra nga zyrtarët për zbatimin e ligjit, pasi në përgjithësi mund të duket gjithçka në rregull te fëmija, por gjuha e tij e trupit, nëse ai/ajo është nën stres, rrallëherë mund të fshihet plotësisht.

2.3. Qëndrimi me fëmijën në ambientet kufitare

Rojet kufitare kanë përgjegjësi për secilin fëmijë, për sa kohë është në mjediset e kufirit. Një fakt i rëndësishëm për t'u pasur në vëmendje në këtë rast është se rojet e kufirit duhet të kujdesen për fëmijë në rrezik derisa të arrijë personi i trajnuar, personi nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve ose ndonjë autoritet tjetër përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe të marrë përsipër rastin.

Rekomandime të përgjithshme (të përshtaten me moshën dhe pjekurinë e fëmijës) që i përshtaten kontrollit të parë dhe/ose të dytë.

- ♦ Përshtatuni me situatën dhe fëmijën - përdorin letër dhe lapsa për të vizatuar fotografi, uluni në dyshe me të, që të krijoni një atmosferë joformale.
- ♦ Mundohuni të bashkëveproni nëpërmjet pyetjeve të hapura (fëmija duhet të jetë i lirë për t'u përgjigjur ashtu si ai/ajo dëshiron, pyetjet "po/jo" duhet të shmangen), shmangni sugjerimin e përgjigjeve sa më shumë që të jetë e mundur, lëroni të flasë lirshëm. Pyetni fëmijën nëse ai/ajo ndihet i/e qetë, nëse ai/ajo ka etje, uri, të ftohtë, të ngrohtë, nëse ka nevojë të shkojë në tualet nëse dëshiron ose ka nevojë për ndonjë gjë tjetër, që mund t'ia ofroni. Ai/ajo mund ta kërkojë nënën ose babanë e tij/saj, andaj mos bëni premtime, të cila nuk mund t'i përmbushni, përndryshe mund ta cenoni besimin midis jush.
- ♦ Pyetni fëmijën nëse ai/ajo ka nevojë për ndihmë mjekësore ose ndonjë trajtim tjetër të veçantë (në varësi të moshës së fëmijës, thjesht mund të pyetni nëse ndjen ndonjë dhimbje).

Po ashtu është e mundur që të pyetet personi që e shoqëron atë, nëse fëmija ka nevojë për ndonjë ndihmë mjekësore ose ndonjë trajtim tjetër të veçantë. Jini të vetëdijshtëm se personi që e shoqëron fëmijën mund ta shfrytëzojë këtë pyetje për të përfituar nga rasti.

- ♦ Vështroni për shenja të lëndimit ose ndonjë sëmundje të dukshme, duke kushtuar vëmendje të veçantë ndaj shenjave të abuzimeve të mundshme (siç është prania e disa lëndimeve, që janë në faza të ndryshme të shërimit, lëndimet e fytyrës të fëmijëve shumë të vegjël, pjesë pa flokë në kokën e fëmijës, etj).
- ♦ Informoni fëmijën (gjatë vijës së dytë të kontrollit) për procedurat në mënyrë që ai/ajo të mund t'i kuptojë.

3. Fëmijët e shoqëruar dhe të ndarë



3.1. Kur iu afrohet pikave të kontrollit dhe në vijën e parë të kontrollit

3.1.1. Skena para kontrollit: A ka diçka të pazakonshme

Fëmija mund të shoqërohet nga një prind, një kujdestar ligjor (fëmijë i pashoqëruar) ose një person i tretë që mund të jetë i rritur ose anëtar i familjes, për shembull, një xhaxha ose njëri gjysh (fëmijë i ndarë). Njerëzit veprojnë më natyrshëm, kur nuk mendojnë se janë nën vëzhgim, kështu që vërtetimi i sjelljes së fëmijëve dhe personit/personave që i shoqëron gjatë lëvizjes, ose duke qëndruar në radhë përpara kontrollit të pasaportave mund të jetë një ushtrim shumë i dobishëm. Shpërndarja e oficerëve me veshjeve civile është gjithnjë me vlerë, në veçanti në aeroportet më të mëdha.

Rojet e kufirit duhet të kujdesen, që të mos bëjnë supozime, ose të mbështeten në paragjykime, kur i vëzhgojnë njerëzit. Është e rëndësishme të mos bëhet diskriminimi mbi bazën e perceptimit kulturor, fetar, përkatësisë kombëtare ose etnike, gjinisë ose faktorëve të tjerë, kur vëzhgohen fëmijët dhe njerëzit që i shoqërojnë ata. Megjithatë, vëmendje shtesë duhet t'u jepet fëmijëve që vijnë nga "shtetet-rajonet me ndjeshmëri për kërkim të azilit".

Një pjesë e rëndësishme e çdo vlerësimi bazohet në përshtypjen e parë, megjithatë për një roje kufitare me përvojë kjo është një çështje e intuitës. Çdo situatë e pazakontë duhet të tërheqë vëmendjen e oficerëve dhe të rezultojë me aktivitet vijues në linjën e dytë të kontrollit (d.m.th. verifikimi i marrëdhënieve midis fëmijës dhe të rriturit, një inspektim i afërt i dokumenteve mbështetëse etj.).

Rojet kufitare me eksperiencë, të mësuar të shohin fëmijë në kufi, mund të përfitojnë nga njohuritë e tyre duke marrë par-

asyshtjet e mëposhtme në lidhje me moshën e dukshme dhe pjekurinë e fëmijës.

Pamja e fëmijës

- i/e turpshëm, ekstravagant i tërhequr ose i frikësuar
- Sjellje e mbyllur e trupit, duke u përpjekur të shfaqet sa më i vogël.
- Nuk ka kontakt me sy, shikon në dysheme
- Duket i shkëputur nga anëtarët e tjerë të grupit
- Veshja: A është krejt e re? A i përshtatet fëmijës apo duket se është e huazuar? A është ajo që mund të prisni? A është veshja e përshtatshme për situatën e dhënë?
- Përpiquni të shikoni në sy personin që e injoron atë.
- Ngjashmëria e karakteristikave me të rriturin/rriturit (nëse personi i rritur paraqitet se është prindi), duke marrë në konsideratë parimin e mosdiskriminimit dhe zbatimin objektiv të tij gjatë profilizimit.
- Shikimi nga afër i ndërveprimeve midis fëmijës dhe prindërit/prindërve ose personit/personave të rritur që e shoqëron/shoqërojnë atë.
- A është fëmija i qetë/i rehatshëm me të rriturit?
- A mund fëmija të flasë lirshëm?
- A tregon fëmija ndonjë shenjë frike ndaj të rriturve?

Është e nevojshme të kushtohet vëmendje shtesë nëse fëmija është i shoqëruar nga vetëm një i rritur ose kur fëmija vjen nga një shtet, prej të cilit vijnë refugjatë, ose nga ndonjë shtet në konflikt ose kur dihet se në atë vend kanë ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Ekziston mundësi e rrallë që foshnjave të fjetur u është dhënë qetësues, me qëllim që të kalojnë përmes kontrollit. Nëse pas një kohe (ndoshta në vijën e dytë të kontrollit) fëmija është akoma në gjumë të thellë, e veçanërisht nëse personi i rritur,

që e shoqëron atë shfaq shenja nervozizmi, sigurisht që duhet të lindin dyshime.

E njëjta metodë mund të përdoret edhe me fëmijët shumë të vegjël, të cilët mund të flasin dhe të paraqesin rrezik për personin shoqëruar. Fëmijët e këtyre mund të konsiderohen shumë të vegjël, që të mund të mësohen se çka duhet ose çka nuk duhet të thonë.

3.1.2. Në vijën e parë të kontrollit

Rojt kufitare në kabinat e kontrollit duhet t'iu kushtojnë vëmendje disa prej këtyre indikatorëve të mëposhtme lidhur me pamjen:

Fëmijët e moshës parashkollore (zakonisht nën 6 vjeç)

- A ka ndonjë gjë të pazakonshme për situatën që shihni?
- A është sjellja e fëmijës në përputhje me gjatësinë e udhëtimit?
- A është fëmija i qetë, i tërhequr, i hutuar, i frikësuar apo i mërzitur?
- A ndjehet fëmija rehat në prani të personit, që e shoqëron atë? Nëse ka frikë nga formaliteti i kontrollit të pasaportave, a qëndron pranë tij/saj personi që e shoqëron?
- A shikon fëmija drejt një tjetër pasagjeri, i cili/e cila përpiket ta injorojë atë? (Në këtë rast pasagjeri tjetër duhet të kontrollohet më detajisht, sepse ai/ajo mund të jetë "përcjellësi")

Fëmijët e moshës shkollore (zakonisht mbi 6 vjeç)

- A ka ndonjë gjë të pazakontë për situatën që shihni?
- A ka frikë fëmija ose a është i shqetësuar?
- A është fëmija i tërhequr/i veçuar/ murmurit ose është jokohorent?
- A është fëmija padrejtësisht i nënshtruar?

- A shikon fëmija drejt një tjetër pasagjeri, i cili/e cila përpigjet ta inorojë atë? (Në këtë rast pasagjeri tjetër duhet të kontrollohet më detajisht, sepse ai/ajo mund të jetë “përcjellësi”)
- A duket fëmija sikur t’i kishin dhënë të konsumojë qetësues?

Të rriturit që shoqërojnë fëmijën

- Nëse ai/ajo prezantohet si prindi, shihni sa i ngjan fëmijës? A është pamja e tij/saj fizike në përputhje me atë të fëmijës? A ka ngjashmëri të sjelljes ose lidhjes mes prindit ose fëmijës, ose veçori të tjera të sjelljes?
- A duket personi i rritur i shqetësuar, i merakosur ose nervoz?
- A duket konsistente dinamika e sfondit kulturor ndërmjet fëmijës dhe personit që e shoqëron atë?

Rojet kufitare gjithashtu mund të parashtrojnë disa pyetje të thjeshta joformale për fëmijën, siç është emri i tij/saj, moshja ose ndonjë detaj tjetër personal. Natyrisht pyetje të tilla janë diskrete dhe duhet të përshtaten me moshën dhe nivelin e pjekurisë së fëmijës, mirëpo ato mund të krahasohen me të dhënat personale, që gjenden në dokumentet e udhëtimit.

Pyetje që mund t’i drejtohen të rriturit dhe mund të rezultojnë me indikacione për trafikim:

- A jeni prindërit/kujdestari/përfaqësuesi ligjor i fëmijës?
- Nëse jo, ku janë ata dhe kush jeni ju?
- Kur i ka parë fëmija për herë të fundit prindërit e tij/saj?
- A ka fëmija me vete ndonjë dokumentacion, siç janë dokumentet e identitetit ose pasaporta?
- Cili është destinacioni i fëmijës dhe qëllimi i udhëtimit?
- Kush e ka organizuar udhëtimin?
- Kush e ka paguar?
- A keni ndonjë fotografi të fëmijës tuaj me ju? (Zakonisht, prindërit kanë fotografi të fëmijëve të tyre të ruajtura në celularin e tyre ose në kuletë.

3.1.3. Kontrolli i dokumenteve

Rojet e kufirit duhet të kontrollojnë marrëdhënien midis fëmijës dhe të rriturit. Gjatë kontrolleve të dokumenteve është e rëndësishme të zhvillohet bisedë e vazhdueshme me udhëtarët, në të njëjtën kohë duke e mbikëqyrur sjelljen e tyre (shih disa nga sugjerimet e përmendura më lart) dhe në veçanti reagimin e fëmijës (stacioni i punës në kontrollin e pasaportave duhet të projektohet që të mundësojë çdo fëmijë të duket qartë, p.sh. një pasqyrë e thjeshtë mund të ndihmojë për të verifikuar nëse ka një fëmijë në pjesën e ulët të kabinës në anën e kundërt).

Përveç kontrolleve standarde, është e nevojshme të përqendroheni edhe në:

- Numrin e fëmijëve dhe numrin e dokumenteve (pasaportat, vizat, etj.). Dokumentet e reja të udhëtimit duhet të kontrollohen më për së afërmi, veçanërisht nëse janë nga vendet ku ato mund të ishin lëshuar përmes mashtrimit ose korrupsionit (sipas analizës së rrezikut në dispozicion).
- Dokumentet mbështetëse dhe biletat e fluturimit (itinerari), me pyetje të shkurtra për arsyen e udhëtimit (kontrollimi i konsistencës midis deklaratave të para dhe dokumenteve mbështetëse të paraqitura). Kur udhëtojnë me fëmijë, të rriturit që i shoqërojnë ata pa ndonjë prapavijë (bona fide) preferojnë të marrin itinerar sa më të drejtpërdrejtë.
- Verifikimi i marrëdhënies juridike ndërmjet fëmijës dhe personit që udhëton me të.
- Te grupet familjare ku ka disa fëmijë: duhet të kontrollohen datat e lindjes dhe mosha e të rriturit/rriturve, për shkak të mospërputhjeve të mundshme.
- Kombësia e fëmijëve: për shembull, nëse fëmija posedon pasaportë të Bashkimit Evropian, ka gjasa të flasë ose së paku të kuptojë një ose më shumë gjuhë evropiane.
- Konsultimi sistematik i Sistemit Kombëtar Informativ të Shengenit (SKIS/NSIS) dhe i bazave të të dhënave të policisë, kur

fëmijët nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian nuk udhëtojnë me të dy prindërit (për shtetasit e vendeve të treta kjo tashmë kërkohet nga Kodi i Kufijve të Shengenit).

Nëse ka ndonjë indikacion se fëmija mund të jetë në rrezik, rojet e kufirit duhet të vazhdojnë me vijën e dytë të kontrollit.

3.2. Vija e dytë e kontrollit

Vija e dytë e kontrollit (nëse është e mundur) duhet të kryhet nga një oficer tjetër, i cili është në dijeni për modus operandin e përdorur nga kontrabandistët dhe trafikantët, si dhe me alarmimet më të fundit.

Të gjitha aktivitetet e mëparshme duhet të rishikohen, ndërsa nëse është e nevojshme edhe kontrollet duhet të përsëriten. Më poshtë janë përshkruar disa kontrolle shtesë.

Sipas Kodit të Kufijve Shengen, fëmija dhe personi që e shoqëron atë duhet të marrin informacion me shkrim në lidhje me qëllimin (dhe procedurën) e kontrollit të tillë, që duhet të kryhet si një procedurë standarde dhe sipas përzgjedhjes së rastit. Ky informacion do të jetë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian dhe në gjuhën(t) e vendit ose vendeve që kufizohen me shtetet anëtare të BE-së. Informacioni në fjalë duhet të përdorë një gjuhë të kuptueshme nga individët, ose që mund të supozohet së është e kuptueshme, ose ta komunikojë atë në mënyrë tjetër të arsyeshme dhe efektive, duke përfshirë edhe angazhimin e përkthyesve, aty ku është e nevojshme.

Gjatë vijës së dytë të kontrollit shfaqet nevoja për të kushtuar vëmendje të posaçme ndaj reagimit të fëmijës dhe pasagjerit që e shoqëron atë.

3.2.1. Udhëtimi

Në rastin e fluturimeve të ndjeshme (sipas analizës së rrezikut), Sistemi për Informacione të Avancuara për Pasagjerët (APIS) duhet gjithmonë të praktikohet para uljes së avionit.

Përveç ekzaminimit logjik të destinacioneve të ndryshme të udhëtimit, në raste të caktuara kontrolli i listës së pasagjerëve dhe listës së emrave të pasagjerëve (LEP), nëse një gjë e tillë lejohet nga legjislacioni shtetëror, ndihmon në drejtim të verifikimit, nëse ka pasagjerë të tjerë që udhëtojnë me të njëjtin rezervim të fluturimit, çka mund t'i vendosë fëmijët në rrezik për krime të rënda. Lehtësuesi/shoqëruesi mund të gjendet në mesin e udhëtarëve tjerë dhe mund të kapet para se ai/ajo të largohet aeroport. Burimet e hapura si <https://www.checkmytrip.com>, mund të përdoren nëse legjislacioni kombëtar nuk lejon kontrollimin e listës së emrave të pasagjerëve (LEP), me qëllim që të konsultohet ky sistem, që përdoret nga transportuesit ajror.

3.2.2. Dokumentet dhe bagazhi

Këshillohet një verifikim i plotë i dokumenteve të udhëtimit dhe dokumenteve mbështetëse, me mundësi për kontaktim të autoriteteve konsullore të vendit që i ka lëshuar dokumentet e udhëtimit. Autoritetet konsullore nuk duhet të kontaktohen në rastin e një fëmije i cili vjen nga një vend prej të cilit ka refugjatë, ose një vend në konflikt, ose vjen nga një vend i njohur për shkelje serioze të të drejtave të njeriut, gjegjësisht ose nëse fëmija njihet si azilkërkues i mundshëm, për shkak se në këto raste kontaktimi i autoriteteve konsullore mund ta vërë fëmijën dhe familjen e tij/saj në rrezik të mëtejshëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit nëse vizat kanë numra serie të njëpasnjëshme, veçanërisht kur ato numra, kanë të bëjnë me pasagjerët të cilët nuk udhëtojnë së bashku.

Nëse nuk është pjesë e vijës së parë të kontrollit, I-24/7 (Baza e të dhënave e Interpolit) duhet të konsultohet, në bazë të legjislacionit kombëtar.

Nëse fëmijët nuk udhëtojnë me bagazhin e tyre, të rriturit duhet që në bagazhin e tyre të kenë disa rroba, lojëra ose lodra që i përkasin fëmijës. Çdo shoqërues i rritur duhet të jetë në gjendje të numërojë disa artikuj, që i përkasin fëmijës, kur u kërkohet ta bëjnë këtë.

3.2.3. Ndërveprimi me fëmijën në vijën e dytë të kontrollit

Kur bisedon me një fëmijë gjatë vijës së dytë të kontrollit, roja e kufirit duhet të marrë parasysh që për një çast ta ndajë atë nga personi i rritur që e shoqëron (por ta bëjë atë në mënyrë diskrete). Nëse duket se fëmija është në rrezik, ai/ajo ka më shumë gjasa ta shpjegojë situatën në mungesë të personit të rritur, i cili ka gjasa të jetë abuziv ndaj tij. Fëmija duhet që në çdo kohë të informohet rreth procesit.

Për më tepër, një roje tjetër kufitare duhet të gjejë ndonjë mos-përputhje ose inkoherencë të informacioneve, duke ia parashtruar të njëjtat pyetje personit të rritur veçmas dhe në mënyrë joformale, me qëllim që të krahasohen përgjigjet e fëmijës dhe shoqëruesit të rritur.

Është gjithmonë e këshillueshme që të jenë të pranishëm dy roje kufitare, nëse është e mundur një burrë dhe një grua, dhe të përipiqen të krijojnë një atmosferë sa më joformale dhe miqësore që të jetë e mundur. Një fëmijë që ndihet i sigurt dhe relativisht i relaksuar ka më shumë gjasa të komunikojë. Mospërputhjet mund të jenë indikatorë të rrezikut, ndonëse është e rëndësishme të minimizohen konfrontimet dhe të kihet parasysh që megjithatë situata mund të përjetohet si formale dhe stresu-

ese për fëmijën, po ashtu edhe për të rriturin (p.sh. në të kaluarën ata mund të kenë pasur përvoja negative me policinë dhe/ose zyrtarët e sigurisë).

Duke pasur dy roje kufitare të pranishëm është gjithashtu një mbrojtje kundër çdo akuze pasuese për ushtrim të frikësimit (ose për ndonjë sjellje tjetër të papërshtatshme). Periudha gjatë së cilës një fëmijë është i ndarë nga personi që e shoqëron atë duhet të jetë e shkurtër, përveçse nëse gjendet ndonjë indikacion i rrezikut.

Gjithnjë është e mundur biseda me fëmijë, jo marrja në pyetje (intervista), madje intervistat zyrtare me ta duhet të zbatohen vetëm kur është e domosdoshme dhe në pajtim me ligjin në fuqi (shih Pjesa 3.3). Çdo dialog me një fëmijë duhet të bëhet në mjediset e projektuara ose të përshtatura për atë qëllim dhe pa shkaktuar vonesa të panevojshme. Mundësisht biseda të mund të zhvillohet së bashku me profesionistët e trajnuar për këto detyra. Nëse është e mundur, intervistuesit duhet të jenë të së njëjtës gjini me fëmijën. Përkthyesit duhet gjithashtu të kontaktohen, nëse fëmija nuk e kupton gjuhën, por edhe me qëllim që të sigurohet një dialog kuptimplotë. Numri i intervistave, si dhe kohëzgjatja e tyre, duhet të mbahen në minimum, ndërsa sa herë të jetë e mundur fëmija duhet të intervistohet nga i njëjti person.

Sugjerohet që të shpjegohet qëllimi i çdo ndërveprimi dhe të përcaktohen rregullat bazë për zhvillim të intervistës: "Nëse nuk e dini përgjigjen, mos u përgjigjini me hamendje, nuk ka përgjigje të drejtë ose të gabuar, vetëm thoni se nuk e dini". "Ti e di më mirë se unë për atë që ka ndodhur". "Nëse nuk dëshiron të përgjigjesh, është gjithçka në rregull". "Mund të më korigjoni ose të mos pajtoheni me mua". "Nëse përsëris një pyetje, kjo nuk do të thotë se përgjigja e parë ka qenë e gabuar". "Nëse një pyetje është shumë e vështirë, mund t'i rikthehemi asaj më vonë". "Thjesht thoni të vërtetën".

Në përgjithësi, fëmijët mund të shoqërohen gjatë intervistës së tyre, në rrethanat e përshtatshme ata mund të shoqërohen nga një i rritur sipas zgjedhjes së tyre, por kërkesa e tyre duhet të refuzohet nëse, për shembull, dyshohet se i rrituri në fjalë është lehtësuesi (i krimi). Kur dyshohet se ka një krim në të cilin ka të përfshirë fëmijë, rojet kufitare duhet të sigurojnë që nga fillimi që të gjitha intervistat me fëmijën viktimë ose dëshmitar të kryhen sipas ligjit kombëtar në fuqi dhe të mund të përdoren si provë (mund të jetë e nevojshme të merret autorizimi paraprak nga një prokuror ose gjyqtar, për intervistën që do të kryhet në prani të një këshilltari ligjor dhe/ose autoriteteve për mbrojtjen e fëmijëve, etj.). Përndryshe rojet kufitare mund të flasin vetëm jo zyrtarisht me fëmijën.

Këtu janë dhënë disa këshilla se si të komunikohet me fëmijët, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e tyre të dukshme:

- ♦ bëhuni të ndjeshëm ndaj shenjave të shqetësimit, siç janë shprehjet e fytyrës, gjestet ose gjuha e trupit;
- ♦ mos prisni ose mos e detyroni që menjëherë të rrëfëhet;
- ♦ bisedoni me fëmijën në mënyrë miqësore dhe në ambient miqësor; bëhuni të hapur, të qartë dhe të ndershëm, nëse është e mundur duke përdorur gjuhën e fëmijës (duke u mbështetur nga një folës i gjuhës amtare të fëmijës);
- ♦ përdorni gjuhë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e fëmijës, duke u shprehur në terma të qarta dhe të lehta;
- ♦ shpjegojini fëmijës atë që po ndodh dhe pse janë duke u kontrolluar rrethanat e tij/saj;
- ♦ ofrojini fëmijës informacione për statusin e tij/saj, të drejtat dhe masat mbrojtëse;
- ♦ siguroni fëmijën se qëllimi juaj është mirëqenia, siguria dhe mbrojtja e tij/saj;
- ♦ parashtroji pyetje të hapura dhe specifike (çfarë, ku, kur, si, kush, pse);

- ♦ jepini fëmijës mundësi për pauza për ujë, tualet ose thjesht kur është i/e lodhur si dhe përgjigjuni nevojave të veçanta ose kërkesave specifike të fëmijës;
- ♦ shmanguni supozimeve për atë që mendon fëmija;
- ♦ kontrolloni nëse fëmija ju ka kuptuar, kërkoni nga ai/ajo që t'ju tregojë se çfarë ka kuptuar;
- ♦ pyetni nëse fëmija ka ndonjë pyetje dhe përgjigjuni pyetjeve të tij/saj.

Vlerësimi sa e njej fëmija vendin e supozuar të prejardhjes së tij/saj.

Për të përcaktuar nëse një fëmijë vërtet e njej mjedisin e vendit nga vjen, gjegjësisht vendi nga i cili thotë se vijnë personi që e shoqëron atë, mund t'i merrni parasysh temat e mëposhtme si mundësi për të eksploruar:

- ♦ programet televizive, filmat vizatimorë dhe muzikantët me popullaritet për të rinj e vendit të tyre të origjinës (informacionet mund t'i gjeni në internet);
- ♦ njohuritë themelore të zonës së tyre të banimit (Aplikacioni Google Earth me pamje rrugore mund të jetë një mjet i dobishëm);
- ♦ detaje për shkollën e tyre, sportet që ata luajnë dhe hapësirën e brendshme të shtëpisë së tyre.

Në çdo kohë, përgjigjet e fëmijës mund të krahasohen me ato të dhëna nga shoqëruesi i rritur ose fëmijët e tjerë brenda të njëjtit grup.

3.3. Zona e transitit dhe porta e kontrollit

Shumica e komenteve të bëra edhe në pjesët e tjera të këtij kapitulli po ashtu zbatohen në lidhje me kontrollët e zonës transit dhe kontrollët e portës, duke pasur parasysh se në ato raste një

ekip sekret (p.sh. rojet e kufirit me rroba civile) mund të vëzhgojnë më mirë sjelljen e udhëtarëve.

Në zonat e ngjeshura për transit, dokumentet, kartat e bordit dhe biletat mund të kenë ardhur të shoqëruar mund me shpejtësi të lehtë të braktisen. Në aeroportet e mbingarkuara, vëzhgimi dhe mbikëqyrja përmes aparateve televizive me qark të mbyllur (CCTV), mund të jenë shumë të vlefshme në detektimin e këtij modus operandi.

3.4. Vendimi përfundimtar dhe udhëzimi

Në të gjitha vendimet, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore si dhe duhet të respektohet parimi i moskthimit.

Një fëmijë duhet të ndalohe vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme dhe gjithnjë në përputhje me ligjin e zbatueshëm kombëtar. Ndalimi mund të bëhet për kohë sa më të shkurtër dhe si masë e fundit në dispozicion. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës ka vendosur që ndalimi i fëmijëve nuk mund të justifikohet për shkak të statusit të migrimit¹². Në çdo kohë, dhe sipas rrethanave, nëse ka një dyshim të arsyeshëm se fëmija mund të jetë në rrezik ose mund të jetë vënë në lëvizje për qëllime trafikimi, ose ka nevojë për mbrojtje duke u bazuar në indikatorët/shenjat e mësipërme, menjëherë duhet të zbatohen mekanizmi i referimit dhe hetimit fillestar, sipas legjisllacionit kombëtar në fuqi, përpara se të ndërmerret ndonjë vendim përfundimtar. Duhet të thirret stafi i specializuar për mbrojtjen e fëmijëve për intervenim në aeroport sipas udhëzimit ose ven-

¹² UNCRC, Komenti i përgjithshëm nr. 6 (2005), mbi trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar ose të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, paragrafi 61.

dosjes fillestare; ndërsa rojet e kufirit duhet t'i kenë në dispozicion detajet e kontaktit.


Një rregull i përgjithshëm në kufi është se fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit e tyre (ose i afërmi që i shoqëron ata), nëse nuk ka dyshim të arsyeshëm se fëmija është në rrezik nga prania e tyre. Agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve do të mund ta konfirmojnë plotësisht këtë aspekt dhe të marrin rastin përsipër.

Mos harroni këto elemente:

- ♦ Përpiquni që koha mes aktivizimit të mbrojtjes së fëmijës, mekanizmit kombëtar të referimit (MKR) dhe dorëzimit aktual të jetë sa më e shkurtër që është e mundur. Për këtë qëllim, sigurohuni që pika e hyrjes (d.m.th kontaktet dhe numrat e personave) të jenë të identifikuar dhe njohur në sistemin kombëtar të mbrojtjes ose referimit.
- ♦ Nëse është e mundur, organizoni një takim koordinues në lidhje me mbrojtjen dhe/ose MKR-në për të diskutuar se si të zgjidhen situatat, në të cilat fëmijët mbërrijnë vonë në mbrëmje, herët në mëngjes ose gjatë festave apo fundjavave.
- ♦ Sigurojini fëmijëve të kenë qasje në shërbimet bazë (ushqim, ujë, tualet, ndihmë mjekësore, etj.) dhe, nëse është e mundur, diçka për t'u argëtuar gjatë kohës që duhet të presin.
- ♦ Gjithnjë informoni fëmijët se çfarë po ndodh dhe çka do të ndodhë.

Rojet kufitare duhet të jenë të vetëdijshëm për procedurat e zbatuara nga transportuesit ajrorë për fëmijët e shoqëruar dhe të ndarë.

4. Fëmijët e pashoqëruar



4.1. Kur i afrohet kontrollit dhe në vijën e parë të kontrollit

4.1.1. Situata para kontrolleve: A ka diçka të pazakonshme

Me siguri mbikëqyrja e sjelljes së fëmijëve të pashoqëruar duhet t'i marrë parasysh **parametrat e ngjashëm, me ato që do të përdoren në rastin e modeleve të sjelljes, të cilat priten nga fëmijët e shoqëruar dhe të ndarë**. Mund të jetë e dobishme të vëzhgohen sjelljet e njerëzve, kur nuk janë të vetëdijshëm se janë duke u mbikëqyruar. Gjithmonë ia vlen të konsiderohet vendosja e oficerëve me rroba civile nëpër aeroportet më të mëdha.

Rojet kufitare nuk duhet të bëjnë supozime ose të përdorin paragjykime kur vëzhgojnë njerëzit. Është e rëndësishme, që kur vëzhgohen fëmijët, të mos bëhen diskriminime mbi bazën e përkatësisë kulturore, fetare, etnike, gjinisë, kombësisë ose faktorëve të tjerë.

Një pjesë e rëndësishme e çdo vlerësimi bazohet në përshtypjen e parë, megjithatë për një roje kufitare me përvojë kjo është një çështje e intuitës. Çfarëdo situatë e pazakontë duhet të tërheqë vëmendjen e oficerëve dhe të rezultojë me aktivitet vijues në linjën e dytë të kontrollit (d.m.th. ekzaminim i plotë i dokumenteve mbështetëse dhe atyre të udhëtimit, vëzhgimi diskret, hetimi i marrëdhënies dhe dinamikës me personin që e pret fëmijën etj.).

Rojet kufitare me eksperiencë, të mësuar të shohin fëmijë duke kaluar kufirin, mund të përfitojnë nga njohuritë e tyre duke marrë parasysh çështjet e mëposhtme në lidhje me moshën e dukshme dhe pjekurinë e fëmijës.

4.1.2. Në vijën e parë të kontrollit

Në kabinat rojet kufitare mund t'i kushtojnë vëmendje disa prej këtyre treguesve shtesë lidhur me pamjen.

- ♦ A ka ndonjë gjë të pazakontë për situatën që shihni?
- ♦ A përshtatet sjellja e fëmijës me gjatësinë e fluturimit nga i cili sapo ka zbritur?
- ♦ A është fëmija i qetë, i hutuar, i tërhequr, jokoherent, i frikësuar apo i mërzitur?
- ♦ A është fëmija duke kërkuar një udhëtar tjetër? (Në këtë rast udhëtari tjetër duhet të kontrollohet më detajisht, sepse ai/ ajo mund të jetë "përcjellësi".)

4.1.3. Kontrollimi i dokumenteve

Pa dyshim që pengesa gjuhësore është problem, mirëpo megjithatë disa fjalë mund të shkëmbehen me fëmijën në mënyrë miqësore, duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e tij/saj. Pyetjet e mundshme duhet të kenë të bëjnë me atë se kush është duke pritur në zonën e mbërritjes jashtë perimetrit të sigurisë, nëse fëmija udhëton shpesh, ku janë prindërit e fëmijës dhe kush e ka sjellë fëmijën në aeroport në vendin e tij/saj të origjinës.

Përveç verifikimeve standarde, është e nevojshme të fokusohemi edhe në këto pika:

- ♦ Dokumentet e paraqitura (pasaportat, vizat, dokumentet mbështetëse etj). Dokumentet e reja të udhëtimit duhet të jenë më shumë të kontrolluara nga afër, veçanërisht nëse janë nga vendet, në të cilat mund të lëshohen si rezultat i mashtrimit ose korrupsionit (duke iu referuar analizës së rrezikut në dispozicion).
- ♦ Disa konsullata lëshojnë viza për fëmijët me emrin e personit që e shoqëron fëmijën në kutinë e komenteve (p.sh. konsullatat britanike); fëmija mund të ketë disa viza të vjetra në

pasaportën e tij/saj me emrin e personit që e pret atë jashtë zonës së mbërritjes.

- ♦ Kontrollimi me kujdes i dokumenteve mbështetëse dhe biletave të fluturimit (itinerari), me pyetje të shkurtra për arsyen e udhëtimit.
- ♦ Konsultimi i SKIS dhe bazave të të dhënave të policisë në bazë të Kodit të Kufijve të Shengenit (KKS), (për shtetasit e vendeve të treta që tashmë është një kërkesë e KKS-së) si dhe, nëse është e mundur, konsultimi në nivel lokal i sistemit të alarmit për rrëmbim të fëmijëve.

Konsiderohet shumë e këshillueshme që të kërkohen zyrtarë policorë të vijës së dytë të kontrollit, që ta identifikojë dhe intervistojë shkurtimisht çdo person që pret fëmijën (ju lutemi referohuni Pjesës 5.2.1).

Nëse ka ndonjë indikacion se fëmija mund të jetë në rrezik, rojet e kufirit duhet të vazhdojnë me kontrollet e vijës së dytë.

4.2. Vija e dytë e kontrollit

Kontrolli i vijës së dytë (nëse është e mundur) duhet të kryhet nga një oficer tjetër, i cili është në dijeni për modus operandin e përdorur nga kontrabandistët dhe trafikantët, si dhe alarmimet më të fundit.

Të gjitha aktivitetet e mëparshme duhet të rishikohen, ndërsa nëse është e nevojshme duhet të përsëriten edhe kontrollet.

Kontrollet e dokumenteve dhe biletave, duke hetuar hollësisht destinacionet e ndryshme të udhëtimit, përjashtimet për zonat transit dhe teknikat e rekomanduara për bashkëveprim me fëmijët janë plotësisht të njëjta sikurse edhe për fëmijët e shoqëruar dhe ata të ndarë.

Sipas Kodit të Kufijve Shengen, fëmija duhet të marrë informacion me shkrim në lidhje me qëllimin (dhe procedurën) e kontrollit të tillë, i cili duhet të kryhet si një procedurë standarde dhe sipas zgjedhjes së rastit. Ky informacion do të jetë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian dhe në gjuhën(t) e vendit ose vendeve që kufizohen me shtetet anëtare të BE-së. Informacioni në fjalë duhet të përdorë një gjuhë të kuptueshme për fëmijën, ose që mund të supozohet së është e kuptueshme për të, gjegjësisht ta komunikojë atë në një mënyrë tjetër efektive, duke përfshirë edhe angazhimin e përkthyesve, aty ku është e nevojshme.

4.2.1. Personi që e pret fëmijën

Një faktor i rëndësishëm është prania e mundshme e një personi që pret për fëmijën. Shpeshherë prioriteti i parë i zyrtarit policor të vijës së dytë të kontrollit është ta identifikojë dhe shkurtimisht ta intervistojë atë person, mirëpo ky kontroll duhet të kryhet vetëm pasi të keni ide për gjendjen e dokumentacionit në dispozicion, nga stafi i linjës ajrore dhe nga fëmija. Pra nevojitet që të kontrolloni më vonë se çfarë thotë personi që e pret fëmijën.

Është e këshillueshme që oficerët në rroba civile të ndjekin për disa metra prapa stafin që shoqëron fëmijën në zonën e pritjes, në mënyrë që të jenë të sigurt se do të paraqitet personi që e pret atë. Trafikanti mund të fshihet, nëse shfaqet një roje kufitare në uniformë duke e shoqëruar fëmijën.

Personi që pret fëmijën jashtë zonës së mbërritjeve duhet të informohet për nevojën e një kontrolli të plotë, si një procedurë standarde sipas përzgjedhjes së rastit, duke i kushtuar vëmendje reagimit të tij/saj.

Nëse fëmija udhëton me bagazhin e tij/saj, ngjan që i rriturit pak a shumë të dijë se çfarë ka në bagazh, sidomos nëse fëmija është

shumë i vogël. Të rriturit duhet të jenë në gjendje të numërojnë disa sende, kur u kërkohet ta bëjnë këtë.

Zyrtari policor duhet të jetë plotësisht i kënaqur, që arsyeja e udhëtimit të fëmijës është legjitime dhe shpjegimi për të është i vërtetë.

Kërkesa për azil gjatë procesit të identifikimit dhe kontrollit, qoftë e dorëzuar nga fëmija ose nga personi që e pret atë, por që e dorëzon në emër të fëmijës, nuk duhet t'i parandalojë ose të shpërqendrojë rojet kufitare nga mbledhja e të gjitha provave të nevojshme dhe ndjekja e procedurës së rregullt.

4.3. Vendimi përfundimtar dhe udhëzimi

Në të gjitha vendimet, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore si dhe duhet të respektohet parimi i moskthimit.

Një fëmijë duhet të ndalohe vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme dhe gjithnjë në përputhje me ligjin e zbatueshëm kombëtar. Ndalimi mund të bëhet për kohë sa më të shkurtër dhe si masë e fundit në dispozicion. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës ka vendosur që ndalimi i fëmijëve nuk mund të justifikohet për shkak të statusit të migrimit¹³. Në çdo kohë, dhe sipas rrethanave, nëse ka një dyshim të arsyeshëm se fëmija mund të jetë në rrezik ose mund të jetë vënë në lëvizje për qëllime trafikimi, ose ka nevojë për mbrojtje duke u bazuar në indikatorët/shenjat e mësipërme, menjëherë duhet të zbatohen mekanizmi i referimit dhe hetimit fillestar, sipas legjislationit kombëtar në fuqi, përpara se të ndërmerret ndonjë vendim

¹³ UNCRC, Komenti i përgjithshëm Nr. 6 (2005), mbi trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar ose të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, paragrafi 61.

përfundimtar. Duhet të thirret stafi i specializuar për mbrojtjen e fëmijëve për intervenim në aeroport sipas udhëzimit ose vendosjes fillestare; ndërsa rojet e kufirit duhet të kenë në dispozicion detajet e kontaktit.

Një rregull i përgjithshëm në kufi është se fëmijët nuk duhet të ndahen nga prindërit ose të afërmit e tyre (të cilët mund t'i presin në zonën e mbërritjes), përveç nëse ka dyshim të arsyeshëm se fëmija është në rrezik nga prania e tyre. Agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve do të mund konfirmojnë plotësisht këtë aspekt dhe të marrin rastin përsipër.

Mos harroni këto elemente:

- ♦ Përpiquni që koha mes aktivizimit të mbrojtjes së fëmijës, mekanizmit kombëtar të referimit (MKR) dhe dorëzimit aktual të jetë sa më e shkurtër që është e mundur. Me këtë qëllim, sigurohuni që pika e hyrjes (d.m.th kontaktet dhe numrat e personave) të jetë e identifikuar dhe e njohur në sistemin kombëtar të mbrojtjes ose referimit.
- ♦ Nëse është e mundur, organizoni një takim koordinues në lidhje me mbrojtjen dhe/ose MKR-në për të diskutuar se si të zgjidhen situatat, në të cilat fëmijët mbërrijnë vonë në mbrëmje, herët në mëngjes ose gjatë festave apo fundjavave.
- ♦ Sigurojini fëmijëve të kenë qasje në shërbimet bazë (ushqim, ujë, tualet, ndihmë mjekësore, etj.) dhe, nëse është e mundur, diçka për t'u argëtuar gjatë kohës që duhet të presin.
- ♦ Gjithnjë informoni fëmijët se çfarë po ndodh dhe çka do të ndodhë.

Rojet kufitare duhet të jenë të vetëdijshëm për procedurat e zbatuara nga transportuesit ajrorë për fëmijët e pashoqëruar.

5. Informazione plotèsuese



5.1. Grumbullimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura siç duhet tregojnë se aktivitetet në terren janë kryer në mënyrë të përshtatshme. Meqenëse pak të dhëna gjenden në nivel të Bashkimit Evropian, në lidhje me fëmijët që kalojnë kufijtë e jashtëm, mbledhja më e mirë e të dhënave mund të identifikojë praktikatat më të mira dhe të shpëtojë një sërë viktimash.

Rojet kufitare mund të luajnë një rol vendimtar në zbulimin e krimeve, në të cilat ka të përfshirë fëmijë. Suksesi i hetimeve të ndërlidhura, shpeshherë varet nga reagimi dhe veprimet e rojeve kufitare, të cilët janë të parët që vërejnë se diçka nuk është në rregull ose mungon. Është e domosdoshme të siguroheni, që çdo pjesë e informacionit që mund të jetë relevante, menjëherë t'iu përcillet autoriteteve përkatëse për reagim të menjëherëshëm. Trafikantët rrallë punojnë të vetëm dhe shpesh e ndryshojë pikën e hyrjes, me qëllim që ta zvogëlojnë rrezikun për t'u kapur; prandaj vetëm mbledhja e gjerë e të dhënave mund të ndihmojë në identifikimin e modus operandit të ngjashëm dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Rekrutimi, transportimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve kërkon një nivel të lartë të organizimit të grupit. Prandaj rojet kufitare kërkojnë një sërë krimesh të ndërlidhura¹⁴.

5.2. Mbrojtja e të dhënave

Rojet kufitare duhet t'i studiojnë në tërësi të gjitha kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave gjatë regjistrimit, përpunimit dhe transferimit të të dhënave për fëmijët. Kuptohet se duhet të ndiqen rregullat për mbrojtjen e të dhënave.

¹⁴ Raporti vjetor i Interpolit 2008 për krimet e lidhura me trafikimin

Në të njëjtën kohë, rojet kufitare duhet të kenë kujdes të mjaftueshëm gjatë regjistrimit, përpunimit dhe transferimit të të dhënave në lidhje me fëmijët. Natyrisht që duhet të ndiqen rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Rregulli i përgjithshëm përcakton që rojet kufitare nuk duhet të përcjellin asnjë informacion specifik në lidhje me fëmijët në vendin e tyre origjinës, e as të ndonjë autoritet i vendit të origjinës që gjendet në vendin e mbërritjes (p.sh. te përfaqësuesit konsullorë).

Në rast nevojë, duhet të identifikohen personat, të cilët mund të jenë duke pritur fëmijën dhe personat e rritur jashtë zonës së mbërritjes (ju lutem gjithashtu referojuni Kapitullit 5, Pjesa 5.2.1).

5.3. Përfaqësuesit konsullorë të shteteve të treta

Duhet të vlerësohen kontaktet me këto delegacione, me qëllim që t'i verifikoni shpejt dokumentet mbështetëse dhe ato të udhëtimit, me kusht që një gjë e tillë të mos e vendosë fëmijën në rrezik të mëtejshëm (p.sh. nëse fëmija shpreh ndonjë qëllim për të kërkuar azil).

Pasagjerët (të rritur) që e shoqërojnë ose personat që e presin fëmijën mund të vihen në kontakt me një person që e flet gjuhën e tyre amtare ose me një përkthyes, që të kenë mundësinë ta shpjegojnë më mirë pozitën e tyre para autoritetet përkatëse.

5.4. Procedurat e transportuesve ajrorë për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar

Dispozitat rreth moshës, që zakonisht përdoren nga linjat ajrore për t'i përcaktuar të miturit e pashoqëruar kanë të bëjnë me fëmijët mes moshës 5 dhe 11 vjeçare (ndonjëherë deri në moshën 15

vjeçare). Informacionet përkatëse zakonisht mund të gjenden lehtë në procedurat e miratuara nga transportuesit ajrorë në uebsajtet e tyre zyrtare.

Zyrtarët lokalë duhet t'i analizojnë procedurat e ndryshme dhe t'i identifikojnë pikat e mundshme të dobëta për fëmijët në aeroportet e tyre.

6. Mbrojtja dhe mekanizmat kombëtare për referim



Sic është specifikuar në Pjesën 2.9, MKR-ja është një sistem i krijuar në nivel kombëtar, i projektuar për të siguruar mbrojtjen e personave vulnerabil dhe të drejtave të tyre përmes një reagimi të koordinuar. Organizimi i MKR-së ndryshon sipas specifikave kombëtare dhe çështjeve në dispozicion.

Për shembull vendet anëtare të BE-së, në bazë të një detyrimi për ndjekjen e së drejtës evropiane janë në proces të krijimit të një mekanizmi të referimit në nivel kombëtar për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore¹⁵. Në disa vende, roli i kërkuar i rojeve kufitare për rastet që përfshijnë fëmijët vulnerabil është sistemuar në një sërë procedurash standarde të veprimit, të cilat mund të aktivizohen lehtësisht. Në vendet e tjera, përgjigja e kërkuar është shumë më pak e qartë, kështu që shërbimet e rojeve kufitare mund të gjenden në situata ku u duhet që të bëjnë vetë rregullime ad-hoc për referim.

Bashkimi Evropian ka promovuar gjithashtu krijimin e mekanizmeve të referimit në nivel kombëtar për trajtim të rasteve të rrëmbimit të fëmijëve. Komisioni ka lëshuar udhëzime¹⁶ dhe ka ofruar mbështetje¹⁷ për të ndihmuar vendet anëtare të krijojnë sisteme alarmi të rrëmbimit të fëmijëve përmes bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu Këshilli i Evropës¹⁸ i ka ftuar vendet anë-

¹⁵ Shih Neni 11 (4) të Direktivës së BE-së 2011/36 / të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, i cili thotë se vendet anëtare do të ndërmarrin masat e nevojshme për të krijuar mekanizma të përshtatshëm, që synojnë identifikimin e hershëm, ndihmën dhe përkrahjen e viktimave në bashkëpunim me organizatat përkatëse që ofrojnë mbështetje.

¹⁶ SEC (2008) 2912 final - Praktika më e mirë për fillim të alarmit ndërkufitar në lidhje me rrëmbimin e fëmijëve: http://ec.europa.eu/justice/funding/rights/call_10014/ramc_ag_annex_5_2008_en.pdf

¹⁷ Për shembull, Bullgaria, Qiproja, Polonia, Sllovakia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar kanë përfutur nga kjo mundësi.

¹⁸ Konkluzionet e Këshillit më 11 nëntor të vitit 2008: <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST%2014612%202008%20REV%202>

tare, të krijojnë mekanizma të tillë dhe të nënshkruajnë marrëveshjet e nevojshme të bashkëpunimit. Duhet të theksohet se diversiteti i sistemeve kombëtare nuk siguron uniformitet në nivel të Bashkimit Evropian. Jo të gjitha vendet anëtare kanë zhvilluar deri më tani mekanizma të tillë. Megjithatë këto mekanizma janë të nevojshme për të siguruar një reagim të shpejtë dhe të koordinuar ndaj rrëmbimeve të fëmijëve, me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë, duke përfshirë edhe rojet kufitare.

Autoritetet kombëtare janë aktorët kryesorë për krijimin e MKR-së dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërsektorial. Sidoqoftë rojet kufitare mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e idesë se autoritetet përkatëse kombëtare duhet të zhvillojnë mekanizma të tillë, aty ku ato ende nuk ekzistojnë.

Frontex-i rekomandon krijimin e një sistemi të lehtë për aktivizim të referimeve. Për çdo mekanizëm të referimit në lidhje me fëmijët, duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme.

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijës duhet të jetë përparësia e parë e të gjitha masave të ndërmarra duke respektuar plotësisht interesat më të mirë të fëmijës.
- Sistemi duhet të jetë sa më efikas dhe më gjerësisht i shtrirë, me qëllim që t'iu përgjigjet me shpejtësi formave të ndryshme të abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit njerëzor. Një gamë e gjerë shërbimesh të specializuara duhet të jenë në dispozicion, në mënyrë që nevojat specifike të individëve të mund të adresohen në mënyrë adekuate.
- Duhet të ndiqet një qasje shumëdisiplinore dhe ndërsektoriale. Sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve janë sistemet më efektive. Prandaj, duhet të përfshihen të gjithë aktorët relevantë dhe të specializuar nga qeveria dhe shoqëria civile.
- Marrëveshjet e krijuara ndërmjet entiteteve të ndryshme duhet të jenë mjaft fleksibël për të trajtuar kompleksitetin e procesit të referimit dhe për t'i adresuar nevojat e ndryshme të fëmijëve në situata të ndryshme. Të gjithë partnerët duhet

të jenë të përfshirë në varësi nga rolet dhe duhet të përcaktohen me kujdes përgjegjësitë e tyre mbi parimin themelor të bashkëpunimit të përcaktuar brenda mekanizmit.

- ♦ Duhet të sigurohet dhe lehtësohet qasja në shërbimet e mbështetjes dhe mbrojtjes.
- ♦ Transparenca dhe ndarja e qartë e përgjegjësive paraqet esencën e mekanizmit efikas të referimit.
- ♦ Ndërtimi mbi mekanizmat ekzistues paraprakë, duke synuar përforcimin e pronësisë lokale duhet të lehtësojë procesin. Qëllim duhet të jetë sigurimi i qëndrueshmërisë.
- ♦ Rregullisht duhet të rishikohet dhe të përditësohet mekanizmi për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e mbrojtjes së fëmijëve. Duhet të kërkohen sinergji me sistemet e tjera relevante të referimit.

Një roje kufitare duhet gjithmonë të ketë në dispozicion sa më poshtë vijon:

- ♦ detajet e kontaktit të shërbimeve "emergjente": mbështetjen e fëmijës 24/7 dhe mbështetjet tjera emergjente;
- ♦ listën gjithëpërfshirëse, me detajet e kontaktit, të të gjithë shërbimeve dhe programeve të mbrojtjes në dispozicion (mjekësore, shëndetit mendor, ligjor, logjistik, etj.), qoftë nga autoritetet kombëtare, shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare ose OJQ-të.

Përfundimisht, është e rëndësishme që rojet kufitare të ndjekin trajnim specifik për mënyrën se si të veprojnë me personat vulnerabil, me fokus të veçantë te fëmijët.

7. Fjalori



- APIS** Sistemi për Informacione të Avancuara për Pasagjerët
- I-24/7** Sistemi i kontrollit të Interpolit
- ILO** Organizata Ndërkombëtare e Punës
- IOM** Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
- OJQ** Organizata joqeveritare
- MKR** Mekanizmi kombëtar i referimit
- PMP** Persona të mitur të pashoqëruar
- SKIS** Sistemi Kombëtar Informativ i Shengenit
- LEP** Lista e emrave të pasagjerëve
- SBC** Kodi i kufijve të Shengenit
- UNCRC** Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1990)
- UNCRSR** Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin e refugjatëve (1951)
- UNODC** Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin



Plac Europejski 6
00-844 Varshavë, Poloni
Telefoni: +48 22 205 95 00
Faksi: +48 22 205 95 01

frontex@frontex.europa.eu
www.frontex.europa.eu



Publications Office